

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A- 145/13
GSK-KPA-A- 146/13
GSK-KPA-A- 147/13
GSK-KPA-A- 148/13
GSK-KPA-A- 149/13
GSK-KPA-A- 150/13**

**Prishtinë,
24 prill 2014**

Në çështjen juridike të:

**N Ž S
S N 24
11... V
S, S**

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

kundër.

Nuk ka

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Esma Erterzi, Kryetare e Kolegjit, Willem Brouwer dhe Sylejman Nuredini, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/164/2012 (lënda është regjistruar në AKP me numrat KPA50909, KPA50912, KPA50913, KPA50914, KPA50917, KPA50921), të datës 5 shtator 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 24 prill 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesat e regjistruara me numrat **GSK-KPA-A-145-2013; GSK-KPA-A-146-2013; GSK-KPA-A-147-2013; GSK-KPA-A-148-2013; GSK-KPA-A-149-2013; GSK-KPA-A-150-2013** bashkohen në lëndën me numrin **GSK-KPA-A-145-2013**.
2. Hidhet poshtë si e papranueshme ankesa e ankuesit **N Ž St** kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës **KPPC/D/A/164/2012**, të datës 5 shtator, sa i përket lëndëve **KPA50909, KPA50912, KPA50913, KPA50914, KPA50917, KPA50921**.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 28 nëntor 2007, paraqitësi i kërkesës **N Z S**, ka paraqitur disa kërkesa si anëtar i familjes së ngushtë të bartësit të supozuar të së drejtës pronësore **Z M S**, duke kërkuar ri-posedimin e ngastrave kadastrale në disa vende të ndryshme në Gjilan. Kërkesat janë regjistruar në AKP me numra të veçantë. Hollësitë e informacioneve në lidhje me pronat e kërkuara janë dhënë në vijim:

| Nr. i Ankesave | Nr. i Kërkesave | Numri(at) e Ngastrave | Sipërfaqja(et) | Fshati | Vendi | Komuna |
|----------------|-----------------|--|--|-----------|--------------------------|--------|
| GSK-A-145-13 | KPA50909 | 43 | 0.20.40 ha | Llashticë | Gladnica | Gjilan |
| GSK-A-146-13 | KPA50912 | (a) 1349; (b) 1350; (c) 1351; (d) 1352. | (a) 0.25.04 ha; (b) 0.03.73 ha; (c) 0.19.67 ha; (d) 0.11.79 ha. | Llashticë | Vlastica Kod Kuce | Gjilan |
| GSK-A-147-13 | KPA50913 | 1801 | 0.02.40 ha | Llashticë | Kriopolje Šamak | Gjilan |
| GSK-A-148-13 | KPA50914 | (e) 2022; (f) 2023; (g) 2024 | (e) 0.07.20 ha; (f) 0.90.86 ha; (g) 1.59.92 ha.. | Llashticë | Jelence | Gjilan |
| GSK-A-149-13 | KPA50917 | 2406 | 0.84.89 ha | Llashticë | Desna Reka Vukodovina | Gjilan |
| GSK-A-150-13 | KPA50921 | (h) 2681; (i) 2682. | (h) 1.53.87 ha; (i) 0.37.66 ha. | Llashticë | Xhurxhevik | Gjilan |

2. Së bashku me kërkesën, ai ka paraqitur, mes tjerash, kopjen e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit P.Br 22/85 të datës 10 janar 1986 për anulimin e Kontratës mbi Dhuratën R.br. 240/77 të lidhur ndërmjet gjyshit të paraqitësit të kërkesës (babait të bartësit të supozuar të së drejtës pronësore), **M S**, si dhuratëdhënës dhe hallave të paraqitësit të kërkesës **L dhe L S** si dhuratëmarrëse.

3. Njoftimet e kërkesave janë bërë nëpërmjet publikimit në Gazetën Zyrtare të AKP-së, si dhe nëpërmjet shpërndarjes së listës dhe Gazetës në organet qeveritare. Nuk është paraqitur ndonjë njoftim për pjesëmarrje për asnjërën lëndë.
4. AKP-ja ka verifikuar se aktgjykimi i paraqitur nga paraqitësi i kërkesës me të cilin anulohet kontrata mbi dhuratën nuk është bërë i plotfuqishëm. Për më tepër, AKP-ja ka gjetur sipas detyrës zyrtare se të gjitha pronat e kërkuara në lëndët e përmendura me lartë, që ndodhen në zonën kadastrale të Llashticës, janë regjistruar në emër të L S dhe L S , në bazë të certifikatës me numrin UL-70403008-00290 të leshura nga Zyra Kadastrale Komunale në Gjilan më 8 janar 2008.
5. Rrjedhimisht, AKP-ja ka kërkuar prova tjera nga paraqitësi i kërkesës për të siguruar një dokument që tregon titullarin e së drejtës pronësore të babait të tij mbi ngastrat kadastrale në fjalë. Paraqitësi i kërkesës nuk është përgjigjur pozitivisht.
6. Më 5 shtator 2012, KKPK-ja me Vendimin KPCC/D/A/164/2012, e ka refuzuar kërkesën e paraqitësit të kërkesës për të gjitha këto ngastra që kanë qenë çështje lëndore të kërkesave në lëndët e regjistruara me numrat KPA 50909, 50912, 50913, 50914, 50917 dhe 50921, pasi që paraqitësi i kërkesës nuk ka arritur të tregojë pronësinë e ndonjë të drejte pronësore mbi pronat e kërkuara para apo gjatë konfliktit të viteve 1998-99.
7. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 16 prill 2013.
8. Ai ka paraqitur ankesë kundër vendimit të cekur nëpërmjet Zyrës së UNHCR-së më 21 maj 2013. Së bashku me ankesën e tij, ai ka paraqitur certifikatën e lindjes së N S ; certifikatën e vdekjes së Z S ; certifikatën e lindjes së L S dhe certifikatën e vdekjes së L S .

Pretendimet e paraqitësit të kërkesës/Palës ankuese

9. Paraqitësi i kërkesës pretendon se këto toka i përkasin babait të tij pasi që kontrata për dhuratën ishte anuluar nga Gjykata në Gjilan (shih parag. 2 më lartë). .
10. Ai më tej ka pohuar se ishte posedues i këtyre tokave para konfliktin dhe posedimin e tyre e kishte humbur kur ishte larguar nga Kosova për shkaqe të sigurisë gjatë konfliktit të armatosur të viteve 1998-1999. Humbja e posedimit është cekur të ketë ndodhur që nga 12 qershori 1999.
11. Në ankesën e tij, ai pohon se KKPK-ja ka marrë vendim të gabuar pasi që të dy hallat e tij të regjistruara si bashkë-pronare nuk ishin gjallë. Ai ka pohuar se L S kishte vdekur më 24 tetor 1978 dhe se L S ishte zhdukur gjatë luftës. Pasi që asnjë informacion nuk është pranuar nga ajo për shumë vite, supozohet se edhe ajo është e vdekur. Ai ka pohuar se pasi që hallat e tij nuk kishin ndonjë fëmijë, ai po ashtu është trashëgimtar i tyre.

12. Në këtë mënyrë, Gjykata Supreme vëren se përkundër faktit se ai ka paraqitur kërkesën si anëtar i familjes së ngushtë së babait të tij, ai nuk ka paraqitur ndonjë vendim mbi trashëgiminë për Z St apo hallën e tij L S . Ai as nuk ka paraqitur ndonjë dokument që tregon për zhdukjen e hallës tjetër të tij L S dhe të trashëgimtarëve të saj.

Arsyetim ligjor:

Bashkimi i ankesave

13. Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale (në tekstin e mëtejme Ligji nr. 03/L-079), parashikon se Gjykata Supreme mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkrira, kur për bashkimin apo shkrirjen e kërkesave është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të kësaj Rregulloreje. Ky nen i mundëson Komisionit që të marrë në konsideratë bashkimin ose shkrirjen e kërkesave me qëllim të shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.
14. Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të cilat janë të zbatueshme në procedurën e apelit pranë Gjykatës Supreme sipas Ligjit nr. 03/L-079, pastaj ato të nenit 408.1, në lidhje me nenin 193 të Ligjit nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore, parashikojnë mundësinë e bashkimit me aktvendim të të gjitha padive nëse ky bashkim i kontribuon efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.
15. Në tekstin e ankesave të parashtruara nga ana e ankuesit, Gjykata Supreme konstaton se përveç numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën saktësisht ushtrohet ankesa përkatëse, e gjithë baza faktike dhe ligjore, si dhe çështja e provave janë plotësisht të njëjta në të 6 (gjashtë) lëndët. Vetëm ngastrat, objekte të së drejtës pronësore, të cilat pretendohen në secilën kërkesë janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë sqaruese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Për më shumë, edhe arsyetimi ligjor i dhënë nga ana e KKPK-së është i njëjtë.
16. Ankesat e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-145/13 deri në 150/13 janë bashkuar në një lëndë të vetme të regjistruar me numrin GSK-KPA-A-145/13.

Pranueshmëria e ankesës

17. Gjykata Supreme ka kompetencë mbi ankesën kundër vendimit të KKPK-së.

18. Ankesa është paraqitur të enjten me 21 maj 2013 ndërsa vendimi i kundërshtuar i KKPK-së i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës enjten me 16 prill 2013.
19. Afati për paraqitjen e ankesës ka skaduar të enjten më 16 maj 2013. Nuk ka pasur ndonjë festë zyrtare që të kërkohej vazhdimi i afatit. As paraqitësi i kërkesës/pala ankuese nuk ka dhënë ndonjë arsye për të justifikuar vonesën e tij në paraqitjen e ankesës. Gjykata Supreme konstaton se ankesa nuk ishte paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve siç parashikohet me ligj (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 – në tekstin e mëtejme Ligji 03/L-079).
20. Ankesat janë të e pa-afatshme. Prandaj, ankesat e abkuesit hidhen poshtë si të papranueshme në përputhje me nenin 13.3 (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Meritat e ankesës nuk do të shqyrtohen nga Gjykata Supreme.

Këshillë ligjore

21. Në përputhje me nenin 13.6 Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Esma Erterzi, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini , Gjyqtar

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it